



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Politika për Ndërgjegjësimin mbi Sigurinë Kibernetike

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Përshkrimi i Politikës.....	3
3. Fusha e zbatimit.....	3
4. Misioni dhe Qëllimet	3
5. Rolet dhe përgjegjësitë	4
6. Mjete dhe Masa Konkrete.....	4
7. Partnerët dhe Bashkëpunimi	4
8. Monitorimi dhe Vlerësimi	5
9. Financimi dhe kalendari Zbatimit.....	5
10. Referencat.....	6
11. Frekuenca e Rishikimit.....	6

1. Hyrje

Politika për Ndërgjegjësimin mbi Sigurinë Kibernetike në Shqipëri synon të forcojë mbrojtjen e individëve, organizatave dhe shoqërisë në tërësi ndaj rreziqeve që hasin në hapësirën kibernetike. Përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit, kjo politikë kontribuon në krijimin e një mjedisi digjital më të sigurt dhe më të informuar, si dhe në reduktimin e rasteve të suksesshme të incidenteve dhe kërcënimeve kibernetike në vend.

2. Përshkrimi i Politikës

Numri i përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Shqipëri ka ardhur gjithnjë e në rritje, e ndikuar edhe nga digjitalizimi i shërbimeve publike elektronike.

Paralelisht, fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit përdorin gjerësisht internetin dhe mediat sociale për komunikim, edukim, informim, si dhe për kryerjen e transaksioneve financiare dhe veprimtarive të biznesit.

Në këtë kontekst, hapësira kibernetike nuk shfrytëzohet vetëm për qëllime të ligjshme, por edhe nga aktorë keqdashës, të cilët synojnë përfitime të paligjshme, kryesisht financiare, duke cenuar sigurinë dhe të drejtat e përdoruesve.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të përdorimit të teknologjisë dhe rritjen e kërcënimeve kibernetike që prekin individë, organizata dhe subjekte publike e private, lind nevoja për ndërmarrjen e iniciativave të strukturuar të edukimit dhe ndërgjegjësimit, me qëllim që përdoruesit e teknologjisë, pavarësisht moshës dhe nivelit të arsimimit, të njohin parimet bazë të përdorimit të sigurt të internetit dhe mënyrat e mbrojtjes nga kërcënimet kibernetike.

3. Fusha e zbatimit

Kjo politikë zbatohet në nivel kombëtar dhe përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe institucionale që përdorin ose ofrojnë shërbime digjitale. Politika adreson veçanërisht institucionet publike, sektorin privat, institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në tërësi.

Politika shërben si dokument udhëzues për hartimin dhe zbatimin e fushatave ndërgjegjëse, programeve të edukimit, trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera që synojnë përmirësimin e njohurive dhe aftësive të shoqërisë në fushën e sigurisë kibernetike.

4. Misioni dhe Qëllimet

Misioni i kësaj politike është ndërtimi i një shoqërie të ndërgjegjësuar dhe të informuar mbi sigurinë kibernetike në Shqipëri, përmes përfshirjes së aktorëve publikë dhe privatë në të gjithë sektorët.

Qëllimet e politikës janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi kërcënimet e sigurisë kibernetike dhe mënyrat e mbrojtjes, duke përfshirë të gjitha grupmoshat.
- Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve publike dhe private dhe organizatave mbi rreziqet dhe sigurinë kibernetike.

- Zgjerimi i fushatave të ndërgjegjësimit në të gjithë sektorët në zhvillim.
- Rritja e bashkëpunimit me aktorët të ndryshëm, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim ndërmarrjen dhe zbatimin e fushatave të ndërgjegjësimit.
- Zvogëlimi i mundësisë që rreziqet kibernetike të ndikojnë tek qytetarët, përmes ndërgjegjësimit dhe edukimit si masë parandaluese.

5. Rolet dhe përgjegjësitë

Roli i AKSK

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka rol drejtues në hartimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike. AKSK përcakton temat prioritare, zhvillon materiale ndërgjegjësuese, koordinon fushatat kombëtare dhe bashkëpunon me institucionet e tjera për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm të kësaj politike.

Roli i institucioneve publike

Institucionet publike kanë përgjegjësi të integrojnë ndërgjegjësimin për sigurinë kibernetike në aktivitetet e tyre të përditshme, veçanërisht përmes trajnimit të punonjësve dhe komunikimit të vazhdueshëm me qytetarët. Ato duhet të kontribuojnë në zbatimin e kësaj politike duke organizuar aktivitete ndërgjegjësuese dhe duke raportuar mbi rezultatet e tyre.

Roli i sektorit privat dhe shoqërisë civile

Sektori privat dhe organizatat e shoqërisë civile janë partnerë të rëndësishëm në zbatimin e kësaj politike. Përmes bashkëpunimit me AKSK dhe institucionet publike, këta aktorë mund të kontribuojnë në përhapjen e mesazheve ndërgjegjësuese, zhvillimin e programeve edukative dhe rritjen e nivelit të përgjithshëm të kulturës së sigurisë kibernetike në shoqëri.

6. Mjete dhe Masa Konkrete

Zbatimi i kësaj politike mbështetet në këto masa kryesore:

- zhvillimi i fushatave gjithëpërfshirëse ndërgjegjësuese dhe edukative për qytetarët, organizatat dhe subjektet publike e private.
- organizimi i seminareve, trajnimeve dhe aktiviteteve edukative në fushën e sigurisë kibernetike për të gjithë sektorët e shoqërisë;
- krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave mbështetës për adresimin e incidenteve kibernetike dhe ofrimin e asistencës teknike për viktimat;
- promovimi i sigurisë kibernetike si pjesë përbërëse e edukimit shkollor dhe universitar.

Masat e parashikuara janë në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe detajohen në Planin përkatës të Veprimit.

7. Partnerët dhe Bashkëpunimi

Zbatimi i kësaj politike mbështetet në bashkëpunimin me aktorë kombëtarë nga sektori publik dhe privat, përfshirë institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e fushës. Në nivel ndërkombëtar, bashkëpunimi realizohet me organizata dhe institucione ku

Shqipëria është anëtare ose partnere, si dhe me agjenci dhe struktura të vendeve aleate, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në sigurinë kibernetike.

8. Monitorimi dhe Vlerësimi

AKSK monitoron zbatimin e politikës përmes analizës së fushatave ndërgjegjëse dhe aktiviteteve të planifikuara sipas kalendarit vjetor. Gjithashtu, shqyrtohen raportimet periodike mbi zbatimin e masave dhe raportet vjetore të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike.

Për vlerësimin e nivelit të ndërgjegjësimit dhe efektivitetit të masave, realizohen pyetësorë dhe instrumente të tjera vlerësuese që matin njohuritë dhe aftësitë e shoqërisë në fushën e sigurisë kibernetike.

9. Financimi dhe kalendar Zbatimit

- Aktivitetet e parashikuara për implementimin e kësaj politike do të financohen me mjete financiare të parashikuara në buxhetin e shtetit dhe donatorë të ndryshëm, ku do të bëhet i mundur zbatimi i masave dhe veprimeve të parashikuara edhe nga Planin e Veprimit 2025-2027 të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, në përputhje me objektivat e kësaj politike.
- Puna për zbatimin e masave të parashikuara nëpërmjet kësaj politike do të fillojë pasi të miratohet. Organizimi dhe implementimi i fushatave të ndërgjegjësimit, trajnimeve dhe seminareve në fushën e sigurisë kibernetike për të gjithë sektorët do të realizohet në përputhje me Planin e Veprimit 2025-2027 të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, që janë në linjë me objektivat e kësaj politike

Aktivitetet e ndërgjegjësimit do të ndahen në grupime, ku për secilin do të ketë materiale të përgatitura në mënyrë specifike. Këto grupime do të përfshijnë:

- Aktivitete ndërgjegjëse për fëmijët
- Aktivitete ndërgjegjëse për prindërit dhe edukatorët
- Aktivitete ndërgjegjëse për të rinjtë, duke përfshirë studentët
- Aktivitete ndërgjegjëse për të moshuarit
- Aktivitete ndërgjegjëse për institucionet dhe punonjësit qeveritarë
- Aktivitete ndërgjegjëse për institucionet e zbatimit të ligjit
- Aktivitete ndërgjegjëse për qytetarët

Aktivitetet e të gjitha grupimeve më lart do të realizohen brenda një viti sipas një kalendarit vjetor që do të përgatitet nga institucioni.

Gjithashtu, çdo muaj do të realizohen aktivitete ndërgjegjëse përmes mediave sociale sipas temave të caktuara. Në lidhje me integrimin e sigurisë kibernetike si pjesë e edukimit shkollor dhe universitar, do të zhvillohen takime ndër-institucionale dhe krijohen grupe pune, në kuadër të implementimit të kësaj politike, dhe në vazhdim.

10. Referencat

Kjo politikë mbështetet në legjislacionin kombëtar për sigurinë kibernetike, Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, si dhe në praktikat dhe standardet ndërkombëtare të njohura në fushën e ndërgjegjësimit në siguri kibernetike.

11. Frekuenca e Rishikimit

Ky dokument rishikohet të paktën një herë në vit për të garantuar që mbetet i përditësuar me zhvillimet teknologjike dhe shoqërore. Rishikimi mund të kryhet edhe më herët në rast se identifikohen nevoja të reja apo sfida të reja që kërkojnë përshtatje lidhur me ndërgjegjësimin në fushën e sigurisë kibernetike.